



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
 NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
 INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
 Kosovar Gender Studies Center



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME
 MINISTER/ URED PREMIJERA
 AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA
 RAVNOPRAVNOST POLOVA/

DEKLARATË E PËRBASHKËT

Kjo deklaratë e përbashkët - e iniciuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Agjencionin për Barazi Gjinore - është hartuar me qëllim të avancimit të barazisë gjinore në Kosovë me mediat si agentë të ndryshimeve sociokulturore. Përmes kësaj deklarate, në pajtim me obligimet që dalin nga Kodi i Etikës për Mediat, si dhe parimet bazë të mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore të mbrojtura e të promovuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, CEDAW, Konventën e Stambollit dhe ligjet tjera në fuqi, synohet angazhimi dhe koordinimi i akterëve për luftimin e dhunës ndaj grave, dhunës me bazë gjinore dhe stereotipeve gjinore.

Mediat nënshkruese të kësaj deklarate zotohen:

- Të respektojnë Kodin e etikës gazetareske dhe t'i përfillin me përpikëri rregullat e raportimit të drejtë, të saktë dhe të paanshëm në kontekstin e barazisë gjinore;
- Të punojnë në eliminimin e seksizmit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në media;
- T'i respektojnë, promovojnë dhe përfshijnë parimet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në politikat e brendshme ekzistuese;
- T'i ngrisin kapacitetet e gazetarëve/eve, për raportim të ndjeshëm gjinor të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Deklarata nënshkruhet vullnetarisht nga palët, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e mediave, siç është rregulluar me legjislacionin në fuqi.

Palët nënshkruese:

Komisioni i Pavarur i Mediave

Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Agjencia për Barazi Gjinore

Mediat:
